



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1727 Prot.

Tiranë, më datë 20.12.2021

VENDIM
Nr. 691, datë 20.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Shërbime konsulence për heqjen e objekteve të përzgjedhura sipas përshkrimit të bërë në raportin e PDYV 5, të cilat rrezikojnë Rrënojat Arkeologjike të Durrësit”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Durrësit dhe Parkut Arkeologjik të qytetit të Durrësit, me aplikues dhe projektues “Engineering Consulting Group” sh.p.k., në bashkëpunim me individ të licencuar në ndërhyrje në pasuri kulturore z. Ogrri Mane dhe individ i licencuar në veprimtari arkeologjike znj. Iris Pojani, zhvillues “Fondi Shqiptaro – Amerikan Zhvillimit” (AADF);
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin zhvillimor me objekt “Shërbime konsulence për heqjen e objekteve të përzgjedhura sipas përshkrimit të bërë në raportin e PDYV 5, të cilat rrezikojnë Rrënojat Arkeologjike të Durrësit”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Durrësit dhe Parkut Arkeologjik të qytetit të Durrësit”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;

5. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

